Komunikata i kushtonte vëmendje të veçantë edhe çështjes së të burgosurve politikë. Në klimën represive që pasoi demonstratat e vitit 1981, qindra shqiptarë ishin arrestuar, dënuar dhe burgosur për shkak të bindjeve dhe veprimtarisë së tyre politike. Për LRSHJ-në, lirimi i tyre pa kushte nuk ishte vetëm një kërkesë humanitare, por një kusht themelor për çdo normalizim të marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe popullit shqiptar. Në këndvështrimin e lëvizjes, ekzistenca e burgjeve të mbushura me aktivistë politikë ishte dëshmi se çështja shqiptare nuk mund të konsiderohej e zgjidhur.

Një vend të rëndësishëm zinte edhe çështja e mërgimtarëve politikë. Komunikata kërkonte mundësimin e kthimit në vendlindje të të gjithë atyre shqiptarëve që ishin detyruar të largoheshin për shkak të përndjekjes politike dhe veprimtarisë së tyre në mbështetje të Republikës Shqiptare në Jugosllavi. Kjo kërkesë pasqyronte realitetin e një periudhe kur shumë veprimtarë kishin gjetur strehim në vendet e Evropës Perëndimore, duke vazhduar prej andej aktivitetin politik dhe kombëtar.

Në fund të kësaj pike, komunikata shprehte një qëndrim të prerë dhe të vendosur: deri sa këto kërkesa të realizoheshin, LRSHJ-ja nuk do të pushonte veprimtarinë e saj. Kjo deklaratë përfaqëson një zotim politik dhe moral, një premtim se lufta për të drejtat kombëtare dhe politike të shqiptarëve do të vazhdonte pavarësisht pengesave, represionit apo sakrificave që mund të kërkonte ajo. (fjala.info, 23 qershor 2026)

3.Bashkimi i Forcave Ilegale Shqiptare në Vitin 1982

Në vazhdim të komunikatës, pas paraqitjes së programit politik, të qëndrimeve ideologjike dhe të objektivave strategjike, autorët ndaleshin edhe të çështjet organizative dhe të mesazhi që dëshironin t'i përcillnin opinionit ndërkombëtar. Këto pika përbëjnë një dëshmi të rëndësishme të përpjekjeve të lëvizjes për të ndërtuar jo vetëm një organizatë të qëndrueshme politike, por edhe një mekanizëm të komunikimit publik dhe të ndërkombëtarizimit të çështjes shqiptare.

Në vazhdim do të paraqes tekstin e komunikatës:

K O M U N I K A T Ë

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste shqiptare në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mbledhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedime përfundimtare për bashkimin e këtyre organizatave në një të vetme. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.

Në ndërkohë bisedime u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982.

Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit përfaqësuesit e të tri organizatave me këtë rast pos tjerash, morën këto vendime e qëndrime:

Që organizata e re të pagëzohet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.

LRSHJ-ja si front unik i rezistencës do të përfshijë në gjirin e saj të gjitha forcat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar në Jugosllavi, si dhe të gjithë patriotët në mërgim, të cilët për shkak të dhunës dhe terrorit serbomadhin janë detyruar t'i lënë trojet e veta të stërlashta.

LRSHJ-ja do të luftojë për formimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, në të cilën duhet të përfshihen të gjitha territoret etnike shqiptare dhe për realizimin e këtij qëllimi do të shërbehet me të gjitha mjetet që lejon etika revolucionare.

Duke u nisur nga bindja politike dhe gjerë tek revolucionin i armatosur po që se e kërkon nevoja.

LRSHJ-ja është thellësisht e bindur se duke luftuar për Republikën Shqiptare në kuadrin e Federatës Jugosllave, si përfaqësuese e vetme e popullit shqiptar në shtetin jugosllav, LRSHJ-ja konsideron se lufta e saj e drejtë i shërben edhe forcimit të unitetit të federatës jugosllave, ruajtjes së paqes në Ballkan dhe stabilitetit të përgjithshëm në Evropë e më gjerë.

LRSHJ-ja llogarit në ndihmën dhe përkrahjen e të gjitha forcave progresive të Jugosllavisë, të cilave u propozon luftë të përbashkët kundër forcave hegjemoniste, kolonialiste, shoviniste dhe forcave tjera reaksionare në Jugosllavi, të cilat kanë sot pozita dominuese në të gjitha strukturat e shtetit si të tilla paraqesin rrezik permanent për të ardhmen e Jugosllavisë për perspektivën e popujve që jetojnë në të dhe për paqen në këtë regjion:

LRSHJ-ja me të gjitha forcat do të luftojë kundër çdo shovinizmi e separatizmi sepse edhe këto izma reaksionare që mund të paraqiten edhe tek ndonjë shqiptar e dëmtojnë unitetin e Jugosllavisë dhe vetvetiu edhe luftën e drejtë që bën populli ynë.

LRSHJ-ja përshëndet qëndrimin e drejtë të të gjithë opinionit progresiv ndërkombëtar, që u solidarizua dhe po solidarizohet me kërkesën e drejtë të popullit tonë për Republikën e vet në kuadrin e Federatës jugosllave.

Përshëndetet qëndrimi i PPSH dhe i qeverisë shqiptare ndaj kërkesës së popullit shqiptar në Jugosllavi për konstituimin e Republikës së vet në kuadrin e Federatës Jugosllave, me çka dëshmojnë interesimin e vet për këtë pjesë të kombit dhe principialitetin e politikës së jashtme ndaj RSFJ, ku respektohen me përpikëri parimet e mos cenimit të sovranitetit dhe integritetit territorial, mos përzierjes në punët e brendshme, respektimit reciprok dhe barazisë së plotë në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ruajtjes së fqinjësisë së mirë duke qenë gjithmonë në gatishmëri të plotë të mbrojnë interesat e pjesës së kombit brenda normave dhe ligjeve ndërkombëtare.

LRSHJ-ja u bën thirrje të gjitha grupeve ekzistuese dhe individëve që luftojnë për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, që t'i bashkohen Lëvizjes për Republikë.

LRSHJ-ja që tash distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë terrorizmi dhe s'do t'ua shtrijë kurrë dorën e pajtimit individëve që i kanë duart e zhytura në gjakun popullit e lëvizjeve që nuk e zbatojnë e çojnë në dëm të popullit, gjithashtu Lëvizja s'do të bashkëpunojë asnjëherë me rrymat e organizata politike që mbajt vulën e tradhtisë, apo qëllimin ta rrezikojnë pavarësinë e RSFJ.

Organi qendror i LRSHJ-së do të jetë “Zëri i Kosovës”.

LRSHJ-ja ua bën me dije si OKB-së ashtu edhe qeverive të të gjitha shteteve që janë për paqe, liri dhe demokraci në botë, se pa iu njohur popullit shqiptar në Jugosllavi statusi i kombit dhe e drejta e patjetërsueshme e tij për Republikën e vet në kuadrin e federatës jugosllave, pa u liruar pa asfar kushti të të gjithë të burgosurit politikë dhe pamundësimin e kthimit në vendlindja të të gjithë të mërguarve që luftuan për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi LRSHJ-ja nuk do të qetësohet kurrë:

- RROFTË REPUBLIKA SOCIALISTE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!
- RROFSHIN TË GJITHË POPUJT E RSFJ!
- RROFTË LËVIZJA PËR REPUBLIKË!

Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ

Nga këndvështrimi historik, kjo pjesë e komunikatës është dëshmi e qartë e procesit të ndërkombëtarizimit të çështjes shqiptare gjatë viteve tetëdhjetë. Ajo tregon se lëvizja ilegale nuk e shihte më veten vetëm si një forcë opozitare brenda Jugosllavisë, por si një subjekt politik që kërkonte të fitonte vëmendjen dhe mbështetjen e opinionit ndërkombëtar.

Në të njëjtën kohë, ajo pasqyron besimin e veprimtarëve të kohës se e drejta për liri, barazi dhe vetëpërfaqësim kombëtar ishte pjesë e parimeve universale që duhej të mbroheshin jo vetëm nga vetë shqiptarët, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare në tërësi. Në këtë kuptim, këto pika të komunikatës përbëjnë një pasqyrë të qartë të ambicieve politike, të vizionit strategjik dhe të kulturës së rezistencës që karakterizoi lëvizjen kombëtare shqiptare në një nga periudhat më të rëndësishme të historisë së saj moderne. (fjala.info, 24 qershor 2026)

4. “Kushtrimi” si Dokument Politik i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi

Pas përfundimit të komunikatës, e cila në mënyrë të strukturuar paraqiste programin politik, organizimin dhe qëndrimet e Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, dokumenti vazhdonte me një tekst tjetër, krejtësisht të ndryshëm në frymë, në stil dhe në mënyrën e komunikimit me lexuesin. Në dy faqet pasuese gjendej një shkrim i titulluar me shkronja të mëdha „KUSHTRIM“, një titull që vetvetiu zgjonte kujtime historike dhe emocione të thella në ndërgjegjen kombëtare shqiptare.

Që në leximin e parë krijohej përshtypja se ky tekst nuk ishte hartuar nga një komision politik apo nga ndonjë organ kolektiv i organizatës, siç ishte rasti me komunikatën. Gjuha e tij ishte më e drejtpërdrejtë, më emocionale dhe më thirrëse. Në të ndihej zëri i një njeriu që shkruante me zemër të trazuar, me mall për atdheun dhe me shqetësim për fatin e popullit të vet. Edhe pse në fund të tekstit nuk figuron asnjë emër, asnjë mbiemër dhe asnjë nënshkrim, stili i shkrimit të krijon bindjen se autori ka qenë një veprimtar i mërgatës shqiptare, një nga ata mijëra shqiptarë që kishin marrë rrugën e kurbetit jo vetëm për arsye ekonomike, por edhe si pasojë e rrethanave politike dhe represionit të kohës.

Motra shqiptare, e ju vëllezër të shtrenjtë, ju të ndjekur, të shtypur e të shpërndarë, para jush, LEVIJZA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI lëshon:

KUSHTRIMIN

Të gjithë ju, i madh e i vogël, në shtetë e shtetëdjatë, kudo që të ndodhemi, kur t'u bjerë në dorë kjo thirrje, lëvizni të gjitha dhe përgjigjuuni shpirtit të atdheut, sepse ai ka nevojë në shumë se kurrë për ju. Pra edhe këtu, radhe organizohuni masovikisht dhe ashtu tok e jani të shtunë meqenëse në ora të stacionit e trenit në Bern të Zvicrës, sepse aty do të ju presin gjindra vëllezër e motra, që kanë ardhur nga anë e anës për t'i dalë atdheut zot, për ta marrë popullin tonë të shumëvuarit në mbrojtje dhe për ta ngritur lart e në lart gjer në diell zërin e trojeve tona të afërta që sot rraheshin në hollet e qasën dhe bajonetën jugosllave. Prandaj lëvizni të gjitha menjëherë e rastit, hushini mosqajmësit e ndryshme dhe të bëheni grusht ai gjithnjë kur e do interesi i atdheut, unike e të fortë si granit dhe ashtu të shokërisë bulevardëve të kënaq, metropole evropiane dhe t'ua përcjellim të gjithë përfundueset të shteteve të botës, rënkimet e mënave që kanë mbetur me dur në gj, sepse jugosllavët na vranë famëjet e ua shkelën burrat me tanka; t'ua përcjellim ofshmat e slijera vëllezëre e motrave tona që po torturohen e masakrohen nëpër burgjet e llahtarshme jugosllave; t'ua përcjellim gjësimin e rrugëve tona të përgjakura që a'po mund ta shpëtojë në qendrën helmetit dhe bajonetën jugosllave... dhe në këtë mënyrë t'ia bëjmë në sije tërë botës se vullneti i një populli dymilionësh s'mund të shtypet me forcën e armëve.

Ne këtë rast, po t'ierrohe do t'u drejtohem se letërkërkë OKB dhe do të kërkojmë nga kjo organizatë, që të ndërmarë masa përkatëse, në mënyrë që shtetë të vetë, jugosllavët, që shpesh botën e shtrëmbetuar për të drejtë e për liri, t'i thotë troq këta mijëra njerëz që tash një kohë të gjatë, protestojnë anë e kënd Evropës, që kanë udhëtuar as këtu, radhe me mijëra kilometra për ta vizituar Zvicrën, por vetëm e vetëm pse janë të shtypur e të shpërndarë, kanë ardhur edhe përmasa këtyre manifestimeve t'i kërkojmë të drejtat e vetë, që ka keni marrë nëpër këmbë... S'ido mend se ky do të jetë një grusht i rëndë për gjakneshit jugosllavë, të cilët me buzeqeshje e gjakthotësi vrasin gra e fëmijë, vetëm pse kanë marrë guximin të kërkojnë Republikë, bukë, punë e liri!

Të dashur bashkëatdhetarë:

Siç e dini ditën e demonstratës sonë, në Beograd fillon nga punimet Kongresi i XII i LKJ, që të kërkojnë llogari prej bashkëqesës së vet për shtypjen brutale të vullnetit të një populli të fortë dhe ngjërëit të apelojmë në ndërgjegjen e atyre delegatëve që me përgjegjësinë që kanë për të ardhmen e shtetit le të insistojnë, në të mirën dhe në interesin e të gjithëve që:

- popullit shqiptar në Jugosllavi t'i njihet statusi i kombit dhe kushtet e drejta e përjetshme që në trojet e veta etnike të ketë Republikën e vet;
- që të lirohen menjëherë të burgosurit politikë;
- që t'u mundësohet kthimi në vendin e tyre të gjithë atyre që përçarsh të dhunës dhe terrorit serboqand janë detyruar t'i lënë familjet e vendlinjë e vet e të marrin botën në uj;
- që sa më parë të ndërmerren masa detyrë krijohen kushte për kthimin tonë, pra të të gjithë punëtorëve, që na kanë shpirt si të lirin kafshë në trojet e punës dhe punësimin tonë afër familjeve;
- që të ndërmerren menjëherë propaganda antisocialiste e serboqandjëve e cila ka për qëllim njohjen e popullit tonë me shpirtet në të përkrahullit;
- që të ndërmerren masa për përmirësimin e standardit të popullit dhe demokratizimin e përgjithshëm të jetës politike në vend...
- që të merren në përgjegjësi të gjithë ata që kanë dorë në vrasjen e gjindëra demonstrantëve shqiptarë dhe t'u bëjë llogaritë të gjithë popujve jugosllave se kërkesat e popullit shqiptar në Jugosllavi, të gjithë popujve

jugosllave se kërkesat e popullit shqiptar në Jugosllavi janë të drejta dhe se nuk kanë për qëllim dobësimin e shtetit, por përkundrazi forcimin e tij...

Punëtorë patriotë në mërgim, Lufta që po bënë populli ynë heroik, ka një perspektivë të sigurtë, ajo nuk po shuhet por po vazhdon se një forcë madhështore ta mahnisë një botë të tërë, ja përshembull këto ditë stafesën e Titos që urryer, atë si abot shtypje e tiranie, populli ynë e priti ashtu siç ajo meritonime plumb e demonstratë dhe ashtu të shpuar nga predha një percolli në Beograd se poqesi për ata që edhe në këtë mënyrë dënd të kalen me popullin; Werrni këtë paqavër të ndyrë, o tiranë të pafytyrë, e mos hargjoni asnjë arda për tekat e një diktatori të vdekur sepse me djeratë tonë, për shkak të tij se shokë ne po i paguamë për çdo vjet nga dy miliardë e gjysmë dollarë vetëm kanatë kredish që janë hargjuar për këso budalallëqes. Populli ynë vëllezër të dashur, për çdo ditë po bënë heroizma të tillë edhe pse në dorë të çdo shqiptari është vendosur nga një patrullë policësh të urryer të armatosur gjër në dhembë, që vrasin e burgosin, që rrahin e përpiqen që edhe nderin tonë ta marrin nëpër këmbë, prandaj është obligim i yni moral që ta përkrahim me të gjitha forcat tona këtë luftë të shenjtë. E ne këtë rast përkrahja me e sira është pjesëmarrja masive në këtë demonstratë, nga e cila me të drejtë pritët se do të jetë madhështore. Prandaj të gjithë ne që po jetojmë me dekaditë tera me mallin përveleues për familjet tanë që d'ua njohim mirë qytetin, vetëm pse barkëndëse - një e Beogradit na kanë shpirt si kafshet në troq, apo pse na chune na kanë detyruar t'ua lënë lantuarin trojeve tona. Të mbledhim të gjithë dhe ta ndërojmë ezrin tonë e të fëmijëve tanë në pjesëmarrjen në këtë demonstratë, sepse vetëm bashkë jemi të fortë, sepse vetëm në luftë e guxim mund t'i fitojmë të drejtat tona, sepse vetëm duke sakrifikuar fitorja dhe takimi me familjet tona është afër.

Pra mirupafshim në sheshin e triandëshit aderit e burzëzisë, atje ku na shpëton të luftojmë duem, Kadriu dhe Bardoshi, trimat tanë e fitet,

- KHOPSHIN PUNËTORËT TANË PATRME QË I PËRGJIGJEN THIRJES SË ATDHEUT
- KHOPTE POPULLI YNË HEROIK
- KHOPTE REPUBLIKA SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI
- KHOPSHIN TË GUJTE POPUT LIRIDASHES TË BOTES
- KHOPTE DEMOKRACI QË KANE THEROR PËR ATDHE
- KHOPTE LEVIJZA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI

Në fakt, mungesa e emrit nuk ishte një dukuri e pazakontë për literaturën ilegale të asaj periudhe. Përkundrazi, anonimiteti ishte pjesë e vetë mekanizmit të mbijetesës së lëvizjes ilegale. Në

kushtet kur organet e sigurimit jugosllav ndiqnin me kujdes çdo shkrim, çdo trakt dhe çdo material propagandistik, fshehja e identitetit të autorit ishte domosdoshmëri. Megjithatë, edhe pse pa emër, teksti mbante vulën e qartë të një autori që jetonte larg vendlindjes, por që mendjen dhe zemrën i kishte të lidhura fort me fatin e Kosovës dhe të shqiptarëve nën Jugosllavi.

Vetë titulli “Kushtrim” kishte një domethënie të veçantë historike. Në traditën shqiptare, kushtrimi nuk ishte thjesht një thirrje. Ai ishte zëri që përhapej nga maja e maleve në kohë rreziku, sinjali që mblidhte burrat e fshatit për mbrojtjen e trojeve, alarmi që zgjonte ndërgjegjen kolektive në momentet më të vështira të historisë. Kushtrimi ka qenë pjesë e kujtesës sonë historike që nga koha e qëndresave kundër pushtuesve të ndryshëm, duke u shndërruar në simbol të mobilizimit dhe të bashkimit kombëtar.

Pikërisht këtë simbolikë përpiquej të ringjallte edhe autori i këtij teksti. Ai nuk shkruante thjesht për të informuar. Ai shkruante për të zgjuar, për të mobilizuar dhe për të nxitur veprim. Në rreshtat e tij ndihej ankthi i mërgimtarit që jetonte larg atdheut, por që ndiqte me dhimbje lajmet për burgosjet, ndjekjet, torturat dhe vrasjet që po përjetonte populli shqiptar pas demonstratave të vitit 1981.

Në shumë pjesë të tekstit, autori i drejtohej bashkatdhetarëve me gjuhën e një njeriu që e ndiente veten pjesë të të njëjtit fat historik. Ai nuk fliste si vëzhgues i largët, por si pjesëmarrës shpirtëror në një betejë të përbashkët. Kjo është një nga karakteristikat më të spikatura të letërsisë politike të mërgatës shqiptare të asaj kohe. Edhe pse fizikisht larg Kosovës, mërgimtarët e ndienin veten pjesë të pandashme të ngjarjeve që zhvilloheshin në atdhe dhe e konsideronin si detyrë morale të kontribuonin në çështjen kombëtare.

Në aspektin historik, tekste të tilla përfaqësojnë një dëshmi të rëndësishme të rolit që luajti mërgata shqiptare në organizimin dhe mbështetjen e lëvizjes kombëtare. Gjatë viteve shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë, qendrat e mërgimit shqiptar në Zvicër, Gjermani, Austri dhe vende të tjera të Evropës Perëndimore u shndërruan në hapësira ku botoheshin gazeta ilegale, shtypeshin trakte, organizoheshin demonstrata dhe mblidheshin mjete financiare për veprimtarinë politike. Në këtë kuptim, “Kushtrimi” nuk ishte vetëm një tekst propagandistik, ai ishte pasqyrë e një bote të tërë emocionesh, sakrificash dhe përpjekjesh që zhvilloheshin larg atdheut, por në funksion të tij.

Prandaj, edhe pse autori mbetet anonim, teksti flet vetë për prejardhjen e tij. Në çdo fjali ndihet malli për vendlindjen, shqetësimi për fatin e popullit dhe besimi i palëkundur se rezistenca do të vazhdojë deri në realizimin e aspiratave kombëtare. Pikërisht kjo e bën “Kushtrimin” jo vetëm një dokument politik të kohës, por edhe një dëshmi emocionale e lidhjes së fortë ndërmjet mërgatës shqiptare dhe lëvizjes për liri e barazi kombëtare në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën Jugosllavi.

Teksti i titulluar “Kushtrim” hapej me një thirrje të fuqishme emocionale dhe politike, e cila që në rreshtat e parë zbulonte karakterin mobilizues të dokumentit. Ndryshe nga komunikata që përdorte një gjuhë më formale dhe institucionale, “Kushtrimi” fillonte me një adresim të drejtpërdrejtë ndaj shqiptarëve, duke i thirrur ata si pjesëtarë të një bashkësie të përbashkët fatkeqësish, vuajtjesh dhe aspiratash kombëtare.

Fjalët hyrëse: “Motra shqiptare, e ju vëllezër të shtrenjtë, ju të ndjekur, të shtypur e të shpërndarë...” bartnin në vetvete një ngarkesë të jashtëzakonshme emocionale. Në këto pak fjalë përmbledhej e gjithë drama historike e shqiptarëve në Jugosllavinë e asaj kohe. Nuk ishte thjesht një përshëndetje ceremoniale. Ishte një përpjekje për të krijuar menjëherë një lidhje shpirtërore ndërmjet autorit dhe lexuesit, një ndjenjë përkatësie të përbashkët që buronte nga përvoja e vuajtjes, diskriminimit dhe rezistencës.

Përdorimi i fjalës “motra” para asaj “vëllezër” nuk ishte rastësor. Ai dëshmonte përpjekjen e autorit për ta përfshirë tërë popullin në këtë thirrje, pa dallim gjinie apo moshe. Në traditën e lëvizjeve kombëtare shqiptare, gruaja shqiptare kishte qenë gjithmonë pjesë e sakrificës dhe e qëndresës, qoftë si nënë e dëshmorëve, si bartëse e familjes në kohë të vështira apo si pjesëmarrëse aktive në jetën kombëtare. Duke iu drejtuar së pari motrave shqiptare, autori i jepte një dimension më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës mesazhit të tij.

Po aq domethënëse është edhe mënyra se si përshkruhen shqiptarët: “të ndjekur, të shtypur e të shpërndarë.” Këto tri cilësime përmbledhin një realitet historik të hidhur që kishte karakterizuar jetën e shqiptarëve në dekadat e mëparshme. Termi “të ndjekur” i referohej represionit politik, arrestimeve, burgosjeve dheurvejimit të vazhdueshëm që ushtronte aparati shtetëror ndaj veprimtarëve dhe qytetarëve shqiptarë. Fjala “të shtypur” shprehte gjendjen e pabarazisë politike, ekonomike dhe kulturore që perceptohej nga shqiptarët në raport me popujt e tjerë të federatës. Ndërsa termi “të shpërndarë” evokonte tragjedinë e mërgimit, largimin e mijëra shqiptarëve nga trojet e tyre dhe shpërndarjen e tyre në vende të ndryshme të Evropës dhe botës.

Në këto pak fjalë, autori arrinte të krijonte një identitet kolektiv të ndërtuar mbi përvojën e përbashkët historike. Ai nuk u drejtohej individëve të veçantë, por një bashkësie kombëtare që, sipas tij, ishte goditur nga i njëjti fat dhe që për këtë arsye duhej të bashkohej rreth të njëjtit ideal.

Pas kësaj hyrjeje, teksti e bënte të qartë burimin e thirrjes. Ajo nuk paraqitej si mendim i një individi të vetëm, por si zëri i një organizate politike që pretendonte të përfaqësonte aspiratat e shqiptarëve. Pikërisht në këtë moment përmendej emri “Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi”, e cila paraqitej si subjekti që po lëshonte këtë kushtrim.

Përdorimi i fjalës “lëshon” ka gjithashtu një simbolikë të veçantë. Në traditën shqiptare, kushtrimi nuk shkruhej thjesht në letër, ai “lëshohej”, përhapej, jehonte nga një krahinë në tjetrën dhe thërriste njerëzit në mobilizim. Kjo gjuhë e zgjedhur me kujdes i jepte dokumentit karakterin e një alarmi kombëtar, të një thirrjeje që synonte të depërtonte në ndërgjegjen e çdo shqiptari, pavarësisht vendit ku jetonte.

Nga pikëpamja historike, kjo hyrje pasqyron në mënyrë të qartë atmosferën politike të fillimit të viteve tetëdhjetë, periudhë kur pas demonstratave të vitit 1981 shqiptarët në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare përjetonin një valë të re represioni politik. Në këto rrethana, literatura ilegale nuk kishte vetëm funksion informues. Ajo synonte të mbante gjallë moralin kolektiv, të forconte ndjenjën e solidaritetit kombëtar dhe të bindte njerëzit se nuk ishin vetëm në përballjen e tyre me pushtetin.

Prandaj, këto rreshta hyrës të “Kushtrimit” nuk duhet të shihen vetëm si një formulë retorike. Ato përfaqësojnë një pasqyrë të gjendjes shpirtërore dhe politike të një periudhe të tërë historike. Në to gërshetohen dhimbja e një populli të përndjekur, mallëngjimi i mërgimtarit për atdheun, revolta ndaj padrejtësive dhe shpresa se përmes bashkimit dhe rezistencës mund të arrihej realizimi i aspiratave kombëtare. Pikërisht kjo e bën hyrjen e “Kushtrimit” një nga pjesët më domethënëse të këtij dokumenti, sepse në pak rreshta ajo arrin të përmbledhë jo vetëm mesazhin e tekstit, por edhe frymën e një epoke të tërë të rezistencës shqiptare.

Pas hyrjes së fuqishme dhe emocionale, në të cilën Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi u drejtohej shqiptarëve si një popull i përndjekur, i shtypur dhe i shpërndarë, “Kushtrimi” kalonte në pjesën e tij më të drejtpërdrejtë dhe më mobilizuese. Tani nuk bëhej më fjalë vetëm për përshkrimin e gjendjes së rëndë politike të shqiptarëve, por për një thirrje konkrete për veprim, për organizim dhe për pjesëmarrje aktive në një manifestim që konsiderohej me rëndësi të veçantë për çështjen kombëtare.

Autori i drejtohej të gjithë shqiptarëve pa dallim moshe, gjinie apo pozite shoqërore. Fjalët “i madh e i vogël, në shtatë e shtatëdhjetë” bartnin simbolikën e përfshirjes së tërë kombit në këtë thirrje. Nuk bëhej fjalë për një apel të kufizuar ndaj veprimtarëve politikë apo anëtarëve të organizatës, por për një thirrje gjithëkombëtare që synonte të zgjonte ndërgjegjen e secilit shqiptar. Në këtë mënyrë, autori përpiquej të krijonte bindjen se çështja kombëtare nuk ishte përgjegjësi e një grupi të vogël njerëzish, por detyrë e përbashkët e të gjithëve.

Po aq domethënëse ishte edhe fraza “kudo që të ndodheni”, e cila zbulon qartë dimensionin e gjerë gjeografik të kësaj thirrjeje. Në fillim të viteve tetëdhjetë, dhjetëra mijëra shqiptarë jetonin dhe punonin në vendet e Evropës Perëndimore, veçanërisht në Zvicër, Gjermani, Austri dhe Francë. Shumë prej tyre kishin emigruar për arsye ekonomike, por jo pak ishin larguar si pasojë e represionit politik. Për autorin e “Kushtrimit”, largësia fizike nuk duhej të shndërrohej në largim shpirtëror nga atdheu. Përkundrazi, ai përpiquej t’u kujtonte mërgimtarëve se pavarësisht kilometrave që i ndanin nga vendlindja, ata mbeteshin pjesë e pandashme e fatit kombëtar.

Në këtë frymë, thirrja fiton një ton pothuajse solemn kur autori kërkon që sapo kjo fletë t’u binte në dorë, ata të linin mënjanë çdo angazhim tjetër dhe t’i përgjigjeshin “zërit të atdheut”. Kjo metaforë është një nga elementet më të fuqishme emocionale të tekstit. Atdheu paraqitet si një qenie e gjallë, si një nënë e plagosur që po thërret bijtë e saj në një moment të vështirë historik. Nuk është organizata që thërret, nuk është autori i panjohur që kërkon pjesëmarrje, por vetë atdheu që ngre zërin dhe kërkon ndihmë nga bijtë e vet. Kjo mënyrë e të shkruarit ishte karakteristike për literaturën patriotike shqiptare, ku lidhja ndërmjet individit dhe atdheut paraqitej si një lidhje morale dhe shpirtërore e shenjtë.

Teksti vazhdon me bindjen se koha kërkonte angazhim të jashtëzakonshëm. Sipas autorit, vendi kishte nevojë për bijtë e vet “më shumë se kurrë”. Kjo shprehje pasqyrore atmosferën e krijuar pas demonstratave të vitit 1981, kur Kosova po kalonte një nga periudhat më të vështira të historisë së saj moderne. Burgosjet masive, gjykimet politike, largimet nga puna, presionet policore dhe kufizimet e të drejtave kombëtare kishin krijuar ndjenjën se populli shqiptar po përballej me një sfidë vendimtare. Në këtë kontekst, mobilizimi i mërgatës shihej si një domosdoshmëri historike.

Më pas, “Kushtrimi” kalon nga gjuha simbolike në një thirrje konkrete organizative. Shqiptarët ftoheshin të mblidheshin në mënyrë masive më 26 qershor, në orën njëmbëdhjetë paradite, në stacionin e trenit në Bernë të Zvicrës. Ky detaj është me rëndësi të veçantë historike, sepse dëshmon për rolin qendror që kishte marrë mërgata shqiptare në organizimin e aktiviteteve politike dhe kombëtare. Zvicra, në atë kohë, ishte shndërruar në një nga qendrat kryesore të veprimtarisë së mërgimtarëve shqiptarë, ku organizoheshin demonstrata, tubime dhe aktivitete sensibilizuese për çështjen e Kosovës.

Por autori nuk mjaftohej vetëm me dhënien e datës dhe vendit. Ai përpiquej të krijonte një atmosferë entuziazmi dhe solidariteti, duke i siguruar lexuesit se në Bernë nuk do të ishte i vetëm. Atje, sipas tij, do të mblidheshin qindra vëllezër e motra, të ardhur nga të gjitha anët. Kjo tablo synonte të forconte ndjenjën e përkatësisë dhe të bashkimit kombëtar. Në një kohë kur shqiptarët jetonin të shpërndarë në shumë shtete dhe shpesh ndiheshin të izoluar nga njëri-tjetri, ideja e një grumbullimi të madh kombëtar kishte një efekt të fuqishëm psikologjik dhe politik.

Në përshkrimin e qëllimit të këtij tubimi, autori përdor një gjuhë të ngarkuar me simbolikë patriotike. Pjesëmarrësit nuk paraqiten thjesht si demonstrues, por si njerëz që po vijnë “për t’i dalë atdheut zot”. Kjo formulë ka rrënjë të thella në traditën historike shqiptare dhe lidhet me idenë e mbrojtjes së vendit në çaste rreziku. Demonstrata paraqitet kështu jo si një akt i zakonshëm proteste, por si një formë e përgjegjësisë kombëtare ndaj një atdheu që po kalonte një periudhë të vështirë.

Po aq i fuqishëm është edhe përshkrimi i gjendjes së shqiptarëve në trojet e tyre. Populli shqiptar cilësohet si “i shumëvuajtur”, ndërsa trojet shqiptare paraqiten si hapësira që po “rënkojnë nën helmetën, çizmen dhe bajonetën jugosllave.” Këto metafora krijojnë një imazh dramatik të realitetit politik të kohës. Helmeta, çizma dhe bajoneta simbolizojnë pushtetin represiv, praninë e forcave të sigurisë dhe përdorimin e dhunës shtetërore kundër popullsisë shqiptare. Përmes kësaj gjuhe figurative, autori synon të zgjojë ndjenja solidariteti, revolte dhe përgjegjësie tek lexuesit.

Në tërësi, kjo pjesë e “Kushtrimit” përfaqëson një nga shembujt më karakteristikë të letërsisë politike dhe mobilizuese të mërgatës shqiptare të viteve tetëdhjetë. Ajo ndërthur mjeshtërisht emocionin me mesazhin politik, mallin për atdheun me thirrjen për veprim, duke e shndërruar një ftesë për demonstratë në një akt simbolik të bashkimit kombëtar. Nëpërmjet këtij teksti pasqyrohet jo vetëm klima politike e kohës, por edhe besimi i fortë i mërgimtarëve shqiptarë se organizimi, solidariteti dhe angazhimi i përbashkët mund të bëheshin një forcë e rëndësishme në mbështetje të aspiratave të popullit shqiptar për liri, barazi dhe vetëpërfaqësim politik.

Në vazhdim të “Kushtrimit”, autori e ngrit edhe më tej tonin emocional dhe mobilizues të thirrjes së tij, duke kaluar nga ftesa për pjesëmarrje në një apel të fuqishëm për bashkim kombëtar. Ai u drejtohet shqiptarëve të mërgatës jo thjesht si pjesëmarrës të një demonstrate, por si bartës të një misioni historik. Në këtë pjesë të tekstit, theksi nuk vihet më vetëm tek nevoja për të qenë të pranishëm në tubim, por tek domosdoshmëria e kapërcimit të çdo pengese që mund të cenonte unitetin kombëtar.

Autori u kërkon bashkatdhetarëve të lënë mënjatë të gjitha angazhimet personale, shqetësimet e përditshme dhe, mbi të gjitha, meritë, pakënaqësitë dhe mospajtimet që mund të ekzistojnë ndërmjet tyre. Kjo thirrje duhet kuptuar në kontekstin e mërgatës shqiptare të viteve tetëdhjetë, e cila, ndonëse e bashkuar nga dashuria për atdheun, shpeshherë përballej me ndarje ideologjike, dallime organizative dhe rivalitete të ndryshme politike. Për autorin e “Kushtrimit”, këto dallime humbnin çdo rëndësi përballë interesit madhor kombëtar. Ai i fton shqiptarët të ngriteshin mbi çdo konflikt të vogël e kalimtar dhe të bashkoheshin rreth një qëllimi të vetëm.

Në tekst përdoret një metaforë e njohur dhe shumë e dashur në traditën shqiptare: shqiptarët duhej të bëheshin “grusht”. Kjo figurë nuk shpreh vetëm bashkim numerik, por unitet të vullnetit, të mendimit dhe të veprimit. Në kulturën politike dhe patriotike shqiptare, grushti simbolizon forcën që lind nga bashkimi. Një gisht i vetëm mund të thyhet lehtë, por kur të gjithë bashkohen në një grusht, ata bëhen të pathyeshëm. Prandaj autori kërkon që shqiptarët të paraqiten para botës si një trup i vetëm politik dhe kombëtar.

Po aq domethënëse është edhe krahasimi me granitin, shkëmbin e fortë dhe të palëkundur. Duke i ftuar bashkatdhetarët të jenë “unikë e të fortë si graniti”, autori përpiqet të krijojë imazhin e një populli që nuk thyhet nga represioni, që nuk dorëzohet përballë dhunës dhe që ruan vendosmërinë e vet pavarësisht sakrificave. Kjo metaforë ishte veçanërisht e rëndësishme në një kohë kur shumë shqiptarë përjetonin burgosje, përndjekje dhe presione të vazhdueshme politike.

Pasi ndërton këtë frymë uniteti, autori e zhvendos vëmendjen te vetë demonstrata që pritej të zhvillohej në zemër të Evropës. Ai e paraqet marshimin nëpër bulevardet e Bernës jo thjesht si një protestë, por si një akt simbolik të ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Në vizionin e tij, demonstruesit nuk do të ecnin vetëm për veten e tyre, ata do të ecnin si përfaqësues të një populli të tërë që nuk kishte mundësi të fliste lirshëm në vendin e vet.

Kjo është arsyeja pse autori përdor vazhdimisht foljen “t’ua përcjellim”. Demonstruesit paraqiten si zëri i atyre që nuk mund të flasin. Ata duhet t’u përcjellin përfaqësuesve të shteteve të botës dhimbjen, vuajtjet dhe kërkesat e popullit shqiptar. Në këtë mënyrë, demonstrata merr karakterin e një tribunali moral ndërkombëtar ku shqiptarët e mërguar paraqiten si dëshmitarë të fatkeqësive që po përjetonte kombi i tyre.

Një nga figurat më prekëse të këtij teksti është ajo e nënave shqiptare që kanë mbetur me duar në gji. Kjo shprehje, e rrënjosur thellë në traditën popullore shqiptare, simbolizon pikëllimin e pafund të nënës që ka humbur birin e saj. Autori përpiqet të sjellë para syve të lexuesit pamjen tragjike të familjeve shqiptare që, sipas tij, kishin humbur më të dashurit e tyre gjatë përplasjeve me pushtetin jugosllav. Kjo figurë nuk synon vetëm të zgjojë dhimbje, por edhe ndjenjën e përgjegjësisë morale tek ata që jetonin në liri në vendet perëndimore.

Po kështu, autori përmend vuajtjet e të burgosurve politikë shqiptarë. Ai flet për mijëra burra dhe gra që, sipas tij, po kalonin nëpër tortura dhe keqtrajtime në burgjet jugosllave. Në literaturën ilegale të kohës, burgu paraqitej shpesh si simbol i sakrificës kombëtare, ndërsa të burgosurit politikë konsideroheshin si dëshmorë të gjallë të kauzës shqiptare. Për këtë arsye, demonstruesit ftohen të bëhen zëri i tyre dhe t’ia tregojnë botës fatin e atyre që nuk kishin mundësi të flisnin vetë.

Një vend të veçantë në këtë pjesë të tekstit zë edhe përshkrimi i trojeve shqiptare si hapësira që po “rënkojnë” dhe të rrugëve që paraqiten si të “përgjakura”. Këto nuk janë vetëm figura letrare. Ato përfaqësojnë mënyrën se si lëvizja ilegale e interpretonte realitetin politik të kohës. Trojet shqiptare paraqiten si një organizëm i gjallë që ndjen dhimbje dhe që kërkon çlirim. Ndërsa helmëta, çizma dhe bajoneta jugosllave shndërrohen në simbole të pushtetit represiv që, sipas autorit, rëndonte mbi jetën e shqiptarëve.

Kulmi i kësaj pjese arrihet me deklarin se demonstrata duhet t’i tregojë botës një të vërtetë themelore: se vullneti i një populli nuk mund të mposhtet me forcën e armëve. Kjo ide përbën thelbin filozofik dhe politik të të gjithë “Kushtrimit”. Ajo pasqyron bindjen e autorit se as represioni policor, as burgjet, as tanket dhe as dhuna shtetërore nuk mund ta zhdukin dëshirën e një populli për liri dhe barazi.

Në aspektin historik, kjo pjesë e dokumentit është një dëshmi e qartë e gjuhës politike dhe emocionale që karakterizonte literaturën ilegale shqiptare pas demonstratave të vitit 1981. Ajo pasqyron jo vetëm gjendjen e rëndë politike të kohës, por edhe besimin e fortë të mërgatës shqiptare se sensibilizimi i opinionit ndërkombëtar dhe bashkimi i shqiptarëve mund të shndërroheshin në faktorë të rëndësishëm në mbështetje të kauzës kombëtare. Përmes kësaj gjuhe të ngarkuar me emocione, metafora dhe simbole historike, autori synonte të zgjonte jo vetëm ndërgjegjen politike të bashkatdhetarëve, por edhe krenarinë, solidaritetin dhe ndjenjën e përgjegjësisë së tyre ndaj fatit të atdheut.

Në vazhdim të “Kushtrimit”, autori përpiqet ta zhvendosë çështjen shqiptare nga kufijtë e një problemi të brendshëm jugosllav në një çështje që meritonte vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare. Ai nuk mjaftohet vetëm me thirrjen për demonstrim dhe sensibilizim publik, por shpalos edhe hapat konkretë politikë që, sipas tij, do të ndërmerrnin organizatorët e manifestimit për ta bërë zërin e shqiptarëve të dëgjohej në forumet më të larta ndërkombëtare.

Në këtë pjesë të tekstit, autori njofton se krahas demonstratës do t’i drejtoheshin me një letër edhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kjo nuk paraqitet thjesht si një procedurë formale apo si një akt simbolik diplomatik. Përkundrazi, në optikën e autorit, ky ishte një veprim me rëndësi të veçantë politike dhe morale. Përmes këtij apeli synohej që çështja e shqiptarëve në Jugosllavi të dilte nga heshtja dhe të paraqitej para institucioneve që pretendonin të mbronin të drejtat e popujve, liritë themelore dhe dinjitetin njerëzor.

Në sfondin e kësaj thirrjeje qëndronte bindja e fortë se bota po informohej në mënyrë të njëanshme për gjendjen në Jugosllavi. Autori e paraqet federatën jugosllave si një shtet që në arenën ndërkombëtare ndërtonte imazhin e vet si mbrojtëse e të drejtave të njeriut, e lirisë dhe e bashkëjetesës ndërmjet popujve. Megjithatë, sipas tij, pas këtij imazhi fshihej një realitet krejt tjetër, i cili përjetohej çdo ditë nga shqiptarët në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare.

Për këtë arsye, letra drejtuar OKB-së paraqitet si një përpjekje për t'i kërkuar bashkësisë ndërkombëtare që të mos mjaftohet vetëm me deklaratat zyrtare të Beogradit, por të dëgjonte edhe zërin e atyre që jetonin nën pasojat e politikave të tij. Në thelb të këtij mesazhi qëndronte ideja se organizatat ndërkombëtare kishin jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin moral të verifikonin nëse parimet që shpallehin publikisht zbatoheshin në praktikë.

Autori përpaket të ndërtojë një kontrast të fortë ndërmjet propagandës shtetërore dhe realitetit që, sipas tij, përjetonin shqiptarët. Ai argumenton se mijëra shqiptarë nuk kishin udhëtuar drejt Zvicrës për arsye turistike apo për të kaluar kohën në një nga vendet më të zhvilluara të Evropës. Përkundrazi, ata kishin ardhur nga larg, duke përshtetur qindra e mijëra kilometra, për të protestuar dhe për të kërkuar atë që e konsideronin si të drejtën e tyre legjitime.

Në këtë mënyrë, demonstrata paraqitet si një akt dëshmie kolektive. Çdo pjesëmarrës shndërrohet në dëshmitar të një padrejtësie historike. Vetë prania e mijëra shqiptarëve në zemër të Evropës interpretohet si provë e gjallë se ekzistonte një problem i pazgjidhur politik dhe kombëtar. Sipas autorit, askush nuk do të merrte rrugë të gjata, nuk do të sakrifikonte kohë, mjete dhe mund për të protestuar në një vend të huaj, nëse nuk do të ndiente mbi vete peshën e diskriminimit, të shtypjes dhe të mungesës së të drejtave. (fjala.info, 25 qershor 2026)

5.Roli i “Kushtrimit” në mobilizimin politik të mërgatës shqiptare pas demonstratave të vitit 1981

Një element i rëndësishëm i kësaj pjese të “Kushtrimit” është përpjekja për ta paraqitur demonstratën si zërin e atyre që nuk mund të flasin vetë. Demonstruesit nuk paraqiten si individë që mbrojnë interesat personale, por si përfaqësues të një populli të tërë që kërkon rikthimin e të drejtave të mohuara. Në këtë kuptim, protesta merr karakterin e një akti kolektiv solidariteti me shqiptarët që jetonin në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare.

Më tej, autori përdor një gjuhë tepër të ashpër dhe emocionale për të përshkruar pushtetin jugosllav. Kjo gjuhë pasqyron klimën politike të krijuar pas demonstratave të vitit 1981, kur represioni, arrestimet dhe përplasjet me forcat e sigurisë kishin lënë gjurmë të thella në kujtesën kolektive të shqiptarëve. Në perceptimin e autorit, pushteti paraqitet si një sistem që nuk ngurron të përdorë dhunën edhe ndaj qytetarëve të pambrojtur, ndërsa kërkesat për Republikë, për punë, për mirëqenie dhe për liri trajtohen si arsye për ndëshkim dhe përndjekje.

Në planin retorik, kjo pjesë e tekstit synon të krijojë një ndjenjë urgjence morale. Autori dëshiron që lexuesi të bindet se heshtja përballë këtyre padrejtësive do të ishte e papranueshme. Prandaj ai e paraqet ndërhyrjen e opinionit ndërkombëtar si një nevojë të domosdoshme dhe demonstratën si një mjet për ta detyruar botën të dëgjojë atë që, sipas tij, po ndodhte në trojet shqiptare.

Nga këndvështrimi historik, ky fragment pasqyron qartë strategjinë që një pjesë e lëvizjes ilegale shqiptare po ndiqte në fillim të viteve tetëdhjetë: ndërkombëtarizimin e çështjes së

Kosovës. Në vend që kërkesat të mbeteshin të kufizuara brenda kufijve të Jugosllavisë, ato synonin të depërtonin në opinionin publik evropian dhe në institucionet ndërkombëtare. Kjo strategji do të bëhej edhe më e rëndësishme në vitet që pasuan, kur çështja e Kosovës do të fitonte gradualisht vëmendje gjithnjë e më të madhe në arenën ndërkombëtare.

Prandaj, kjo pjesë e “Kushtrimit” nuk është vetëm një apel emocional drejtuar bashkatdhetarëve në mërgim. Ajo përfaqëson edhe një dëshmi të qartë të vetëdijes politike që po formësohej në radhët e lëvizjes shqiptare: bindjen se lufta për të drejta kombëtare nuk duhej zhvilluar vetëm në rrugët e Kosovës apo në mjediset e mërgatës, por edhe në hapësirat ndërkombëtare ku formësohej opinionin botëror dhe ku vendosej fati i shumë çështjeve politike të kohës.

Në vijim, “Kushtrimi” merr formën e një programi të qartë kërkesash politike, shoqërore dhe kombëtare. Pas thirrjes emocionale drejtuar mërgimtarëve shqiptarë dhe pas përpjekjes për ta ndërkombëtarizuar zërin e protestës, autori i drejtohet përsëri bashkatdhetarëve me një ton më të përqendruar, më argumentues dhe më politik. Ai i quan ata “të dashur bashkatdhetarë”, duke e ruajtur kështu lidhjen e ngrohtë emocionale me lexuesin, por njëkohësisht duke kaluar në një fazë tjetër të tekstit: në numërimin e kërkesave që duhej të paraqiteshin para opinionit jugosllav dhe ndërkombëtar.

Autori e lidh demonstratën e planifikuar me një ngjarje të rëndësishme politike që po zhvillohej në të njëjtën kohë në Beograd: fillimin e punimeve të Kongresit XII të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Kjo lidhje nuk ishte e rastësishme. Përkundrazi, ajo tregon se organizatorët e protestës kërkonin ta vendosnin demonstratën në një moment politik me jehonë të gjerë, kur vëmendja e strukturave shtetërore dhe partiake jugosllave ishte e përqendruar në Beograd. Duke e përmendur këtë kongres, autori synonte që kërkesat e shqiptarëve të mos mbeteshin vetëm në rrugët e Bernës, por të jehonin edhe në qendrën politike të federatës jugosllave.

Në këtë kuadër, “Kushtrimi” u bënte thirrje delegatëve të kongresit që të mos mbyllnin sytë para gjendjes së rëndë të shqiptarëve. Autori kërkonte që ata të kërkonin llogari nga udhëheqja e tyre për shtypjen brutale të vullnetit të një populli të tërë. Kjo fjali bart një peshë të madhe politike, sepse e paraqet çështjen shqiptare jo si një problem lokal apo administrativ, por si çështje të ndërgjegjes politike të tërë Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, përgjegjësia nuk i atribuohet vetëm organeve të sigurisë apo udhëheqjes lokale, por edhe strukturave më të larta partiake dhe shtetërore.

Thirrja drejtuar ndërgjegjes së delegatëve kishte gjithashtu një karakter moral. Autori nuk u drejtohej vetëm si përfaqësues politikë, por si njerëz që kishin përgjegjësi për të ardhmen e shtetit. Ai kërkonte prej tyre që, në emër të së mirës së përbashkët dhe në interes të të gjithë popujve të Jugosllavisë, të insistonin në zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare. Kjo tregon se autori nuk e paraqiste realizimin e kërkesave shqiptare si interes të ngushtë kombëtar, por si kusht për stabilitetin, drejtësinë dhe të ardhmen e vetë federatës.

Kërkesa e parë dhe më themelore ishte njohja e shqiptarëve në Jugosllavi si komb dhe pranimi i të drejtës së tyre të patjetërsueshme për të pasur Republikën e vet në trojet etnike. Kjo ishte zemra politike e gjithë dokumentit. Në rrethanat e Jugosllavisë socialiste, ku republikat kishin status më të lartë politik e kushtetues sesa krahinat autonome, kërkesa për Republikë përfaqësonte synimin për barazi të plotë juridike dhe politike me popujt e tjerë të federatës. Për

autorin, kjo nuk ishte një kërkesë e tepruar, por një e drejtë që buronte nga historia, nga përbërja etnike dhe nga realiteti demografik i shqiptarëve.

Pas kësaj, teksti kalon te *kërkesa e dytë* për lirimin e menjëhershëm të të burgosurve politikë. Kjo kërkesë lidhej drejtpërdrejt me pasojat e demonstratave të vitit 1981 dhe me valën e arrestimeve që kishte përfshirë Kosovën dhe viset e tjera shqiptare. Të burgosurit politikë paraqiteshin si dëshmi e gjallë e shtypjes shtetërore dhe si simbol i sakrificës për të drejtat kombëtare. Lirimi i tyre, sipas frymës së dokumentit, do të ishte hapi i parë drejt zbutjes së represionit dhe hapjes së një rruge më demokratike për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Një kërkesë tjetër, *e treta* me radhë që kishte peshë të madhe njerëzore dhe historike ishte mundësimi i kthimit në vendlindje të të gjithë atyre që ishin detyruar të largoheshin nga dhuna dhe terrori serbomad. Këtu shfaqet drama e mërgimit politik shqiptar. Autori nuk e sheh largimin nga atdheu si zgjedhje të lirë, por si pasojë të dhunës, përndjekjes dhe mungesës së sigurisë. Shprehja se këta njerëz ishin detyruar “të marrin botën në sy” bart një dhimbje të thellë popullore dhe shpreh fatin tragjik të atyre që kishin lënë familjet, shtëpitë dhe vendlindjen për të shpëtuar nga represioni.

Në vijim, dokumenti trajton edhe çështjen e punëtorëve shqiptarë në mërgim. Kjo pjesë i jep “Kushtrimit” një dimension social dhe ekonomik, përveç atij politik. Në *kërkesën e katërt*, autori kërkon që të krijohen kushte për kthimin e punëtorëve shqiptarë dhe punësimin e tyre pranë familjeve. Në këtë formulim ndihet kritika ndaj politikave ekonomike të Jugosllavisë, të cilat, sipas autorit, kishin detyruar shumë shqiptarë të largoheshin si fuqi punëtore jashtë vendit. Shprehja e ashpër se ata ishin “*shitur si të ishin kafshë në tregun e punës*” pasqyron ndjenjën e poshtërimit dhe shfrytëzimit që përjetonte një pjesë e mërgatës punëtore.

Kërkesa e pastë e cila bënte fjalë për ndërprerjen e propagandës antishqiptare zë gjithashtu një vend të rëndësishëm. Pas demonstratave të vitit 1981, mediat zyrtare jugosllave shpesh i paraqisnin kërkesat shqiptare si nacionaliste, armiqësore apo kundërrevolucionare. Për autorin e “Kushtrimit”, kjo propagandë kishte për qëllim njollosjen e një populli të tërë me shpifje të rënda dhe të paskrupullta. Prandaj, ndërprerja e saj shihej si kusht për krijimin e një klime më të drejtë politike dhe për njohjen e realitetit të vërtetë të shqiptarëve në Jugosllavi.

Një tjetër kërkesë, *e gjashtë* me radhë, lidhej me përmirësimin e standardit të jetesës dhe demokratizimin e përgjithshëm të jetës politike në vend. Kjo tregon se dokumenti nuk kufizohej vetëm në kërkesat kombëtare, por prekte edhe çështje të gjera sociale dhe demokratike. Autori e kuptonte se çështja shqiptare kishte edhe dimension ekonomik: varfëria, papunësia, pabarazia në zhvillim dhe mungesa e mundësive kishin ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen e shqiptarëve. Prandaj, zgjidhja e problemit nuk mund të ishte vetëm formale apo kushtetuese, ajo duhej të shoqërohej me përmirësim real të jetës së njerëzve dhe me hapje demokratike të sistemit politik. Në fund, “Kushtrimi” kërkonte që të merreshin në përgjegjësi të gjithë ata që kishin dorë në vrasjen e demonstruesve të paarmatosur. Kjo kërkesë- *e shtatë* me radhë, bartte peshën më të rëndë morale të dokumentit. Ajo kërkonte drejtësi për viktimat dhe përgjegjësi për dhunën shtetërore. Në të njëjtën kohë, autori kërkonte që të gjithë popujve të Jugosllavisë t’u bëhej e qartë se kërkesat e shqiptarëve ishin të drejta dhe nuk synonin dobësimin e shtetit. Përkundrazi, sipas tij, realizimi i këtyre kërkesave do ta forconte Jugosllavinë, sepse një shtet i mbështetur mbi padrejtësi, pabarazi dhe dhunë nuk mund të ishte i qëndrueshëm.

Në tërësi, kjo pjesë e “Kushtrimit” paraqet një platformë të dendur politike, kombëtare, sociale dhe morale. Nëpërmjet saj, autori artikulon kërkesat kryesore të shqiptarëve në Jugosllavi: *njohjen si komb, krijimin e Republikës, lirinë e të burgosurve politikë, kthimin e të përndjekurve dhe të mërgimtarëve, ndërprerjen e propagandës antishqiptare, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe vënien para përgjegjësisë të atyre që kishin ushtruar dhunë ndaj demonstruesve*. Këto kërkesa e shndërrojnë “Kushtrimin” nga një tekst thirrës në një dokument të mirëfilltë politik, i cili pasqyron si dhimbjen e kohës, ashtu edhe vizionin e lëvizjes për një të ardhme më të drejtë dhe më të barabartë për shqiptarët në Jugosllavi.

Në pjesën pasuese të “Kushtrimit”, autori e drejton vëmendjen posaçërisht te mërgata shqiptare, të cilën e konsideron një pjesë të pandashme të trupit kombëtar dhe një forcë të rëndësishme në përpjekjet për realizimin e aspiratave politike të shqiptarëve në Jugosllavi. Ai u drejtohet me fjalët “*Punëtorë patriotë në mërgim*”, një formulim që përmbledh dy identitete të rëndësishme të shqiptarëve të diasporës së asaj kohe: identitetin e punëtorit emigrant dhe identitetin e atdhetarit të angazhuar për fatin e kombit.

Që në fillim të kësaj pjese, autori përpiket të ngjallë optimizëm dhe besim në suksesin e kauzës shqiptare. Ai shpreh bindjen se lufta që po zhvillonte populli shqiptar nuk ishte një përpjekje e përkohshme apo e destinuar për t’u shuar, por një lëvizje me perspektivë të qartë historike. Në frymën e literaturës politike të kohës, rezistenca shqiptare paraqitet si një proces që po fitonte vazhdimisht forcë dhe që, sipas autorit, po tërhiqte vëmendjen e opinionit publik shumë më gjerë sesa kufijtë e Jugosllavisë. Kjo bindje shërbente si një instrument motivues për lexuesit, duke u përcjellë idenë se sakrificat e bëra nuk ishin të kota dhe se kauza e tyre po fitonte jehonë gjithnjë e më të madhe.

Për ta ilustruar këtë frymë kundërshtimi, autori ndalet te një nga simbolet më të rëndësishme të Jugosllavisë së pasluftës: Stafeta e Titos. Në kulturën politike jugosllave, kjo stafetë ishte shndërruar në simbol të unitetit të federatës dhe të kultit politik që ishte ndërtuar rreth figurës së Josip Broz Titos. Për shumë shqiptarë të angazhuar në lëvizjen ilegale, ajo përfaqësonte jo vetëm sistemin politik ekzistues, por edhe strukturën që, sipas tyre, kishte mundur vazhdimin e padrejtësive ndaj shqiptarëve.

Autori e përshkruan reagimin e shqiptarëve ndaj këtij simboli si një akt refuzimi politik. Në interpretimin e tij, kundërshtimi ndaj stafetës nuk drejtohej thjesht kundër një ceremonie shtetërore, por kundër gjithë sistemit që ajo simbolizonte. Në këtë mënyrë, stafetës i atribuohet kuptimi i një shenje të shtypjes dhe të centralizmit jugosllav, ndërsa reagimi kundër saj paraqitet si shprehje e revoltës së një populli që nuk pranonte më të identifikohet me simbolet e pushtetit që e konsideronte represiv.

Një vend të rëndësishëm zë edhe kritika ndaj gjendjes ekonomike të Jugosllavisë dhe barrës së borxheve që rëndonin mbi qytetarët e saj. Në frymën e kritikës politike të asaj kohe, autori argumenton se mjetet financiare të shtetit po shpenzoheshin për projekte dhe simbole që nuk sillnin përfitime reale për popullin, ndërkohë që qytetarët, përfshirë shqiptarët, përballeshin me vështirësi ekonomike dhe me pasojat e krizës së thellë financiare që kishte filluar ta godiste federatën në fillim të viteve tetëdhjetë. Kjo pjesë e tekstit pasqyron një dimension më të gjerë të pakënaqësisë, ku çështja kombëtare lidhej ngushtë me problemet sociale dhe ekonomike.

Më tej, autori rikthehet te përshkrimi i gjendjes së shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare. Ai i paraqet ata si një popull që vazhdon të rezistojë pavarësisht pranisë së vazhdueshme të forcave policore, arrestimeve dhe presioneve të ndryshme. Në gjuhën e tij ndihet bindja se rezistenca nuk po zhvillohej vetëm në rrugë apo në demonstrata, por edhe në jetën e përditshme të njerëzve të zakonshëm. Çdo familje shqiptare paraqitet si një vatër e qëndresës, ndërsa çdo akt i mbijetesës morale interpretohet si pjesë e luftës së përgjithshme kombëtare.

Për autorin, kjo gjendje krijon një detyrim moral për mërgatën shqiptare. Ai argumenton se shqiptarët që jetonin në Perëndim nuk mund të mbeteshin indiferentë ndaj asaj që po ndodhte në vendlindje. Përkundrazi, ata kishin detyrimin të mbështesnin me të gjitha mundësitë e tyre përpjekjet e bashkëkombësve. Në këtë kontekst, pjesëmarrja në demonstratë paraqitet si forma më konkrete dhe më e drejtpërdrejtë e solidaritetit.

Në mënyrë të veçantë, autori ndalet te drama e mërgimit shqiptar. Ai përshkruan me tone prekëse jetën e atyre që kishin kaluar vite e dekada larg familjeve të tyre. Malli për fëmijët, largësia nga vendlindja dhe ndarja nga familja paraqiten si plagë të hapura që shoqëronin përditshmërinë e mërgimtarëve. Në tekst shfaqet qartë bindja se emigrimi nuk ishte thjesht një zgjedhje ekonomike, por një pasojë e kushteve politike dhe sociale që kishin detyruar shumë shqiptarë të largoheshin nga trojet e tyre.

Kjo përvojë e përbashkët e mërgimit shndërrohet në një argument shtesë për pjesëmarrje. Autori kërkon që shqiptarët të mos e harrojnë identitetin e tyre dhe as sakrificat që kishin bërë. Ai i fton të mblidhen së bashku jo vetëm për të protestuar, por edhe për të ruajtur dinjitetin e tyre kombëtar dhe për të nderuar emrin e vet dhe të fëmijëve të tyre. Kjo është një nga temat më të forta emocionale të gjithë “Kushtrimit”: ideja se veprimi politik është njëkohësisht detyrë ndaj brezit të tashëm dhe trashëgimi për brezat që do të vijnë.

Në fund, autori rikthehet te ideja e bashkimit si kusht për sukses. Ai thekson se vetëm përmes unitetit, guximit dhe sakrificës mund të fitohen të drejtat e mohuara. Në këtë logjikë, fitorja nuk paraqitet si rezultat i një akti të vetëm, por si fryt i një përpjekjeje të gjatë kolektive. Takimi me familjet, kthimi në vendlindje dhe realizimi i aspiratave kombëtare shihen si horizonte të arritshme, por vetëm nëse shqiptarët mbeten të bashkuar dhe të vendosur në qëllimet e tyre. Kjo pjesë e “Kushtrimit” përbën një shembull karakteristik të retorikës patriotike të mërgatës shqiptare të viteve tetëdhjetë. Në të ndërthuren kujtesa historike, kritika politike, shqetësimet sociale dhe emocionet personale të mërgimtarit. Përmes një gjuhe të ngarkuar me simbolikë dhe ndjenja, autori përpiket të krijojë tek lexuesi bindjen se pjesëmarrja në kauzën kombëtare nuk është vetëm një zgjedhje politike, por një detyrim moral ndaj atdheut, familjes dhe historisë së vet popullore.

Në pjesën përmbyllëse të “Kushtrimit”, gjuha politike dhe mobilizuese e dokumentit arrin kulmin e saj emocional. Pas gjithë argumenteve, thirrjeve, kritikave dhe kërkesave politike që janë shpalosur përgjatë tekstit, autori mbyll mesazhin e tij me një apel të fuqishëm për bashkim dhe pjesëmarrje, duke e shndërruar demonstratën e paralajmëruar në një ngjarje me domethënie jo vetëm politike, por edhe morale, historike dhe kombëtare.

Shprehja “*Pra mirupafshim në sheshin e trimërisë, nderit e burrërisë*” nuk duhet kuptuar thjesht si një ftesë për t’u takuar në një vend të caktuar. Në gjuhën simbolike të autorit, demonstrata shndërrohet në një hapësirë morale ku maten virtytet më të larta të traditës shqiptare. Ajo paraqitet si një arenë ku provohet besnikëria ndaj atdheut, ku nderi lidhet me përkushtimin ndaj çështjes kombëtare dhe ku burrëria nuk kuptohet vetëm si trimëri fizike, por si gatishmëri për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e popullit.

Kjo mënyrë e të shkruarit mbështetet fuqishëm në kulturën historike shqiptare, ku nocionet e nderit, trimërisë dhe burrërisë kanë zënë një vend të rëndësishëm në vetëdijen kolektive. Për breza të tërë shqiptarësh, këto vlera kanë qenë të lidhura ngushtë me mbrojtjen e atdheut, me sakrificën për lirinë dhe me përgjegjësinë ndaj komunitetit. Pikërisht për këtë arsye, autori e paraqet demonstratën jo si një ngjarje të zakonshme politike, por si një vazhdimësi të traditës së gjatë të qëndresës kombëtare.

Më tej, teksti evokon figurat e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, të cilët në ndërgjegjen e lëvizjes ilegale shqiptare tashmë kishin fituar statusin e martirëve dhe të simbolit të sakrificës kombëtare. Përmendja e tyre nuk është e rastësishme. Në fillim të viteve tetëdhjetë, vrasja e tyre në Gjermani kishte tronditur thellë mërgatën shqiptare dhe kishte lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e lëvizjes kombëtare.

Autori i paraqet ata si mësues të rezistencës dhe si shembuj të përkushtimit ndaj idealit të lirisë. Kur shkruan se “*atje ku na mësuan të luftojmë Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi*”, ai nuk i referohet vetëm veprimtarisë së tyre konkrete politike, por edhe trashëgimisë morale që kishin lënë pas. Në perceptimin e autorit, ata nuk ishin vetëm individë, por përfaqësonin një brez të tërë veprimtarësh që kishin sakrifikuar jetën për çështjen kombëtare. Për këtë arsye, demonstrata paraqitet si një vazhdim i rrugës së tyre dhe si një formë nderimi për idealet që kishin mbrojtur. Pas kësaj hyrjeje solemne, teksti kalon në një seri parullash përmbyllëse, të cilat përbëjnë thelbin ideologjik dhe emocional të dokumentit. Këto parulla kanë strukturën karakteristike të literaturës ilegale dhe të manifestimeve politike të kohës. Ato nuk janë thjesht slogane, por përmbledhin në mënyrë të shkurtër gjithë mesazhin e “Kushtrimit”.

Parulla e parë i kushtohet punëtorëve shqiptarë në mërgim, të cilët autori i cilëson si patriotë që i përgjigjen thirrjes së atdheut. Kjo pasqyron rolin qendror që mërgata kishte fituar në lëvizjen kombëtare shqiptare. Në sytë e autorit, punëtori emigrant nuk ishte vetëm një njeri që siguronte jetesën larg vendlindjes; ai ishte një pjesëtar aktiv i rezistencës kombëtare, një njeri që përmes pjesëmarrjes në demonstrata, përkrahjes materiale dhe angazhimit politik kontribuonte në fatin e kombit.

Parulla “*Rroftë populli ynë heroik*” përfaqëson një element tjetër të rëndësishëm të diskursit politik të kohës. Populli shqiptar paraqitet si subjekt kolektiv i historisë, si bartës i rezistencës dhe si protagonist i përpjekjeve për liri. Termi “*heroik*” nuk përdoret vetëm për të lavdëruar të kaluarën, por edhe për të forcuar vetëbesimin e shqiptarëve në të tashmen. Ai synon të krijojë bindjen se një popull me histori sakrificash dhe qëndrese ka forcën për t’i përballuar edhe sfidat e kohës.

Në qendër të parullave qëndron natyrisht thirrja “*Rroftë Republika Shqiptare në Jugosllavi*”. Kjo është ideja kryesore politike e gjithë dokumentit. Ajo përfaqëson objektivin për të cilin,

sipas autorit, po zhvillohej e gjithë veprimtaria politike dhe organizative e lëvizjes. Përmes kësaj parulle, kërkesa për Republikë shndërrohet në simbol të aspiratës për barazi politike, për vetëpërfaqësim dhe për njohje të identitetit kombëtar shqiptar brenda federatës jugosllave.

Po aq domethënëse është edhe thirrja *“Rrofshin të gjithë popujt liridashës të botës”*. Kjo parullë tregon se autori përpiqet ta vendosë kauzën shqiptare brenda një konteksti më të gjerë ndërkombëtar. Lufta e shqiptarëve nuk paraqitet si një konflikt i izoluar kombëtar, por si pjesë e përpjekjeve universale të popujve për liri, drejtësi dhe dinjitet. Në këtë mënyrë, çështja shqiptare lidhet me idealet e përgjithshme të emancipimit dhe të të drejtave të popujve.

Një vend të veçantë zë edhe parulla *“Lavdi dëshmorëve që ranë theror për atdhe”*. Kjo është një formulë e njohur e kulturës politike shqiptare, e cila shpreh respektin dhe mirënjohjen për ata që kanë sakrifikuar jetën në emër të idealeve kombëtare. Përmes saj, autori përpiqet të krijojë një urë ndërmjet brezave të rezistencës, duke e paraqitur sakrificën e të rënëve si themel moral mbi të cilin duhet të vazhdojë lufta politike e brezit të tanishëm.

Në fund, dokumenti mbyllet me parullën *“Rroftë Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi”*, duke e rikthyer vëmendjen te organizata që kishte lëshuar këtë thirrje. Kjo parullë shërben si një afirmim i rolit që lëvizja i atribuonte vetes si bartëse e aspiratave politike të shqiptarëve dhe si organizatore e rezistencës së tyre.

Në tërësi, pjesa përmbyllëse e “Kushtrimit” është ndërtuar si një kombinim i kujtesës historike, simbolikës patriotike dhe mobilizimit politik. Ajo pasqyron mënyrën se si lëvizja ilegale shqiptare e fillimviteve tetëdhjetë përpiqej të ndërthurte figurat e martirëve, traditat e qëndresës, idealin e Republikës dhe rolin e mërgatës në një narrativë të vetme kombëtare. Për këtë arsye, këto rreshta përfaqësojnë jo vetëm fundin e një dokumenti politik, por edhe një pasqyrë të fuqishme të kulturës së rezistencës që karakterizoi një periudhë të rëndësishme të historisë moderne shqiptare.

Teksti i “KUSHTRIMIT” fillonte kështu:

“Motra shqiptare, e ju vëllezër të shtrenjtë, ju të ndjekur, të shtypur e të shpërndarë, para jush, LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI lëshon:

KUSHTRIMIN

Të gjithë ju, i madh e i vogël, në shtatë e shtatëdhjetë, kudo që të ndodheni, kur t’ju bjerë në dorë kjo thirrje, lëreni të gjitha dhe përgjigjuni zërit të atdheut, sepse ai ka nevojë më shumë se kurrë për ju. Pra edhe kësaj radhe organizohuni masovikisht dhe ashtu tok ejani të shtunën më 26 qershor në ora 11 në stacionin e trenit në Bernë të Zvicrës, sepse aty do të ju presin qindra vëllezër e motra, që kanë ardhur nga anë e anës për t’i dalë atdheut zot, për ta marrë popullin tonë të shumëvuajtur në mbrojtje dhe për ta ngritur lartë e më lartë gjerë në diell zërin e trojeve tona të stërlashta që sot rënkojnë nën helmetën, çizmen dhe bajonetën jugosllave.

Prandaj lërinin të gjitha punët dhe merit e rastit, hudhini mospajtimet e ndryshme dhe të bëheni grusht si gjithnjë kur e do interesi i atdheut, unikë e të fortë si graniti dhe ashtu të shkojmë bulevardëve të kësaj metropole evropiane dhe t’ua përcjellim të gjithë përfaqësuesve të shteteve të botës, rënkimet e nënave që kanë mbetur me duar në gji, sepse jugosllavët ua vranë fëmijët e ua shkelen burrat me tanke; t’ua përcjellim ofshamjet e mijëra vëllezërve e motrave tona që po torturohen e masakrohen nëpër burgjet e llahtarshme jugosllave, t’ua përcjellim gjënimin e rrugëve tona të përgjakura që s’po mund ta durojnë më çizmen, helmetën dhe bajonetën

jugosllave... dhe në këtë mënyrë t'ia bëjmë me dije tërë botës se vullneti i një populli dy milionësh s'mund ta shtypet me forcën e armëve.

Me këtë rast pos tjerave do tu drejtohem me letër edhe OKB-së dhe do të kërkojmë nga kjo organizatë, që të ndërmarrë masa përkatëse, në mënyrë që anëtarësisë së vet, Jugosllavisë, që shurdhon botën së trumbetuari për të drejtat e për liri, t'u thotë troç: këta mijëra njerëz që tash një kohë të gjatë, protestojnë anë e këndë Evropës, s'kanë udhëtuar as kësaj radhe me mijëra kilometra për të vizituar Zvicrën, por vetëm e vetëm pse janë të shtypur e të shfrytëzuar, kanë ardhur edhe përmes këtij manifestimi t'i kërkojnë të drejtat e veta, që ua keni marrë nëpër këmbë. S'do mend se ky do të jetë një grusht i rëndë për gjakpirësit jugosllavë, të cilët me buzëqeshje e gjakftohtësi vrasin gra e fëmijë, vetëm pse kanë marrë guximin të kërkojnë Republikë, bukë, punë e liri!

Të dashur bashkatdhetarë:

Siç e dini ditën e demonstratës sonë, në Beograd fillon nga punimet Kongresi i XII i LKJ, që të kërkojnë llogari prej udhëheqjes së vetë për shtypjen brutale e vullnetit të një populli të tërë dhe njëherë të apelojmë në ndërgjegjen e atyre delegateve që me përgjegjësinë që kanë për të ardhmen e shtetit le të insistojnë, në të mirën dhe në interesin e të gjithëve që:

1. popullit shqiptar në Jugosllavi t'i njihet statusi i kombit dhe kuptohet e drejta e patjetërsueshme që në trojet e veta etnike te ketë Republikën e vet;
2. që të lirohen menjëherë të burgosurit politikë;
3. që tu mundësohet kthimi në vendlindje të gjithë atyre që për shkak të dhunës dhe terrorit serbomadh janë detyruar t'i lënë familjet e vendlindjen e vet e të marrin botën në sy;
4. që sa më parë të ndërmerren masa dhe të krijohen kushte për kthimin tonë, pra të të gjithë punëtorëve, (që na kanë shitur si të ishim kafshë në tregun e punës), dhe punësimin tonë afër familjeve;
5. që të ndërpritet menjëherë propaganda antishqiptare e serbomëdhenjve e cila ka për qëllim njollosjen e popullit tonë me shpifjet më të paskrupullta;
6. që të ndërmerren masa për përmirësimin e standardit të popullit dhe demokratizimin e përgjithshëm të jetës politike në vend...
7. që të merren në përgjegjësi të gjithë ata që kanë dorë në vrasjen e qindra demonstratave duarthatë dhe tu bëhet me dije të gjithë popujve jugosllavë se kërkesat e popullit shqiptar në Jugosllavi janë të drejta dhe se nuk kanë për qëllim dobësimin e shtetit, por përkundrazi forcimin e tij...

Punëtorë patriotë në mërgim,

Lufta që po bën populli ynë heroik, ka një perspektivë të sigurtë, ajo nuk po shuhet por po vazhdon me një forcë madhështore të mahnisë një botë të tërë, ja për shembull këto ditë stafetën e Titos së urryer, atë simbol shtypjeje e tiranie, populli ynë e priti ashtu siç ajo meriton me plumb e demonstratat dhe ashtu të shpuar nga predha ua përcolli në Beograd me porosi për ata që edhe në këtë mënyrë dinë të tallen me popull. Merreni këtë paçavure të ndyrë, o tiran zë pafytyrë, e mos harxhoni miliarda për tekat e një diktatori të vdekur sepse me djersën tonë, për shkak të tije me shokë ne po i paguajmë për çdo vjet nga dy miliard e gjysmë dollarë vetëm kamat kredish që janë harxhuar për këso budallallëqesh. Populli ynë, vëllezër të dashur, për çdo ditë po bënë heroizma të tillë edhe pse në derë të çdo shqiptari është vendosur nga një patrullë policësh të urryer të armatosur gjerë në dhëmb, që vrasin e burgosin, që rrahin e përpiqen që edhe nderin tonë ta marrin nëpër këmbë, prandaj është obligim i yni moral që ta përkrahmi me të gjithë forcat tona këtë luftë të shenjë. E në këtë rast përkrahja më e mirë është pjesëmarrja masive në këtë demonstratë, nga e cila me të drejt pritet se do të jetë madhështore. Prandaj të

gjithë ne që po jetojmë me dekada te tëra me mallin përvëlues për fëmijët tanë që s'ua njohim mirë fytyrën, vetëm se barkmëdhenjtë e Beogradit na kanë shitur si kafshët në treg, apo pse me dhunë na kanë detyruar tua lëmë lamtumirën trojeve tona. Të mblidhemi të gjithë dhe ta nderojmë emrin tonë e të fëmijëve tanë me pjesëmarrjen në këtë demonstratë, sepse vetëm bashkë jemi të fortë, sepse vetëm në luftë e guxim mund ti fitojmë të drejtat tona, sepse vetëm duke sakrifikuar fitorja dhe takimi me familjet tona është afër.

Pra mirupafshim në sheshin e trimërisë, nderit e burrërisë, atje ku na mësuan të luftojmë Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, trimat tanë me fletë.

RROFSHIN PUNTORËT TANË PATRIOT QË I PËRGJIGJEN THIRRJES SË ATDHEUT
RROFTË POPULLI YNË HEROIK

RROFTË REPUBLIKA SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI

RROFSHIN TË GJITHË POPUJT LIRIDASHËS TË BOTËS

LAVDI DËSHMORËVE QË RANË THEROR PËR ATDHE

RROFTË LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI

(fjala.info, 26 qershor 2026)

(Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha, ROLI I MËRGATËS SHQIPTARE NË KUJTESËN HISTORIKE TË KOSOVËS, fejtton në zemrashqiptare.net dhe në fjala.info, pjesët 28, 29, 30, 31 dhe 32 të datave 21, 23, 24, 25 dhe 26 qershor 2026)